



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



Emërtimi i lëndës: Didaktikë e gjuhës angleze

Titullari / pedagogu i lëndës: Prof.Dr Shpresa Delija, Dr. Elvana Shtepani

Ngarkesa: 4 kredite;40 orë mësimore; 20 leksione /20 seminarë

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti III / Semestri I

Lloji i lëndës: E detyruar

Programi i studimit: Bachelor në gjuhën angleze

Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës: shpresa.delija@unitir.edu.al,
elvana.shtepani@unitir.edu.al

OBJEKTIVAT E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Didaktika është një disiplinë që lidhet ngushtë me disiplinat e tjera si: linguistika, psikologjia, psikolinguistika, sociolinguistika, dhe shkencat e edukimit.

Kursi pajis studentët e ciklit të parë të studimit Bachelor me njohuri teorike bazë për mësimin e gjuhës angleze në shkollën e mesme.

Gjatë kursit studentët do të njihen me vështrimin historik të Didaktikës, njihen me qasjen që kjo disiplinë ka me mësimin e gjuhës së huaj, me konceptet e kompetencave komunikative në gjuhën e huaj, me besimet dhe qëndrimet e mësuesve ndaj mësimin të gjuhës së huaj etj. Studentët njihen me konceptet bazë rreth pedagogjisë së mësimdhënies të gjuhëve të huaja.

Kursi ndihmon studentët të reflektojnë mbi qëndrimet e tyre ndaj gjuhës së huaj dhe rolit të mësuesit, duke bërë që të analizojnë, përmirësojnë dhe përvetësojnë teknika që nxisin të mësuarit aktiv të nxënësve në një kontekst në ndryshim.

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Ky kurs synon që studentët:

- Të përftojnë njohuri bazë rreth teorisë së mësimin të gjuhës së huaj në shkollë.
- Të përftojnë njohuri bazë rreth lëndës së Glotodidaktikës duke marrë në konsideratë perspektivat diakronike dhe sinkronike të zhvillimit të kësaj disipline.
- Të kuptojnë dhe të dallojnë metodat dhe teknikat e mësimdhënies.
- Të zhvillojnë aftësi për të zbatuar këto metoda dhe teknika në klasë dhe t'i përdorin ato në funksion të nevojave dhe gjendjes aktuale në klasë.

Rezultatet e të nxënit:

studentët janë të aftë:

- Të demonstrojnë nivel të lartë në njohjen e dijeve bazë rreth llojeve të ndryshme të metodave e teknikave të mësimit të gjuhës angleze si gjuhë e huaj (diskutim aktiv në leksion dhe në seminare).
- Të demonstrijnë nivel të lartë në diskutime dhe debate rreth çështjeve të ngritura në leksione rreth mësimit të gjuhës angleze si gjuhë e dytë.
- Të prezantojnë individualisht dhe në grup punime rreth temave të ndryshme (8 - 10 minuta maksimumi).
- Të analizojnë dhe të japin mendime rreth prezantimeve të shokut/ shokëve.
- Të demonstrojnë aftësi të larta në shkrimin e detyrave të kursit të caktuara nga pedagogu i lëndës.